



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. ____ prot.

Tiranë, më 13.5.2022

Lënda: Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik në çështjen ankim kundër vendimit nr. 410, datë 30.6.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Atalanta Zeqiraj

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, pasi u shqyrtuan dhe iu nënshtruan debatit gjyqësor të gjitha kërkimet dhe propësimet e palëve, si dhe provat e administruara, Komisioneri Publik, duke mbajtur në konsideratë zhvillimin e jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, vlerëson se çdo gjykim eventual për lënien në fuqi të vendimit nr. 410/2021, të Komisionit, nga ana e kësaj Trupe, do të ishte një përfundim i bazuar dhe logjik, por sërish vlerësojmë se do të duhet të jetë me një arsyetim të ndryshëm.

Referuar shkaqeve të ankimit, në zbatim edhe të Rekomandimit të ONM-së, Komisioneri Publik çmon se arsyetimi i ndryshëm në këtë rast do të ishte i nevojshëm dhe do të ndihmonte si orientim për raste të ngjashme, lidhur me faktin nëse parimi i proporcionalitetit, i zbatuar nga Komisioni në vendimin objekt shqyrtimi gjyqësor, është në përputhje me standardet ekzistuese të arsyetuara në jurisprudencën e Kolegjit.

Komisioneri Publik, duke pasur në vëmendje natyrën specifike që paraqet rasti, lidhur me konfliktin e interesit dhe deklaramit të interesave private të subjektit të rivlerësimit, ku konstatohet se për pasuritë e deklaruara nga subjekti dhe ato në pronësi të personit tjetër të lidhur me të, të atit, për origjinën e krijimit të tyre nuk ka asnjë dyshim mbi ekzistencën e të ardhurave dhe mënyrës së krijimit të tyre të rrjedhura nga biznesi, çdo dyshim eventual, i ngritur për qëllim të aplikimit të nenit D, pika 3, të aneksit të Kushtetutës, do duhet të arsyetohet në favor të subjektit të rivlerësimit.

Për sa më sipër, nga aktet e administruara dhe provat e shqyrtuara për qëllim të këtij gjykimi, provohet se pasuritë e deklaruara në përdorim nuk mund të lidhen me subjektin e rivlerësimit, për burimin e krijimit të tyre provohet se ato rrjedhin nga të ardhurat e biznesit të personit tjetër të lidhur, të atit të subjektit, ato rezultojnë të deklaruara në pasqyrat financiare përkatëse të shoqërisë, lëvizjet e këtyre të ardhurave janë bërë nëpërmjet sistemit bankar, fakte, në analizë të të cilave, edhe në prezencë të ndonjë mangësie formale, nuk justifikojnë cenimin e vendimit dhe vendosjen e ndonjë mase disiplinore.

Ndërsa, për sa i përket gjendjes së konfliktit të interesit, si i vetmi shkak ankimi i mbetur në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, Komisioneri Publik vlerëson se ai nuk është i mjaftueshëm për ndryshimin e vendimit të Komisionit.

Kërkimi përfundimtar

Nga sa u parashtrua më sipër, në vlerësim të përgjithshëm të procedurave të procesit të rivlerësimit, ashtu sikurse dhe praktika ka treguar, kërkimi i ankimit të Komisionerit Publik, kundrejt juridiksionit kontrollues të Kolegjit, mund të jetë alternativ kur rrethanat faktike dhe juridike e lejojnë atë.

Për sa u arsyetua, përfundimi logjik në rastin konkret do të ishte lënia në fuqi e vendimit nr. 410, datë 30.6.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, por duke i kërkuar Kolegjit ndryshimin e arsytimit dhe argumentimit ligjor.

KOMISIONERI PUBLIK

Irena NINO